

Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për periudhën Janar - Gusht 2017.

Me Ligjin Nr. 130/2016, datë 15.12.2016, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2017", fondet e akorduara për funksionimin e aktivitetit të institucionit të Avokatit të Popullit, sipas artikujve, paraqiten si më poshtë:

1. Shpenzime Personeli

Fondi i akorduar për periudhën Janar - Gusht 2017, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli është 49.164 mijë lekë, ndërsa realizimi është 45.607 mijë lekë ose 92,80%, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë në plan 8.296 mijë lekë, ndërsa realizimi është 6.393 mijë lekë ose në masën 77%. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) si 8/mujor janë realizuar në masën 90,50%.

Gjatë periudhës Janar – Gusht 2017, institucioni nuk kanë përdorur të plotë fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, për shkak të mosplotësimit të strukturave organike.

Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2017, nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë kësaj periudhe.

Ka patur mungesa në 4/mujorin e parë:

- 1- Komisioner në Mekanizmi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, ç 'njerëzor ose poshtëruës (MPKT),
- 1- Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve,
- 1- Këshilltar,
- 1- Ndhmëskomisioner të MPKT-së ,
- 1- Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit dhe Koordinimit të Projekteve

Gjatë katërmujorit të dytë institucioni ka patur këto mungesa:

- 1- Komisioner në Mekanizmi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, ç 'njerëzor ose poshtëruës (MPKT)
- 1- Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre,
- 1- Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve
- 1- Ndhmëskomisioner të MPKT-së ,
- 1- Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit dhe Koordinimit të Projekteve.

2. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar për periudhën Janar – Gusht 2017 ishte 11.220 mijë lekë, i ndryshuar me shkresë nr. 6579/1 Prot., datë 12.05.2017, “Transferim fonde për vitin 2017” në 11.020 mijë lekë, ndërsa realizimi është 6.023 mijë lekë ose 54.67% e buxhetit të ndryshuar.

Për vitin 2017 shpenzimet operative, janë përdorur për pagesat e blerjeve për kancelari, materiale pastrimi, furnizime me materiale të tjera zyre, njoftime publikime në gazeta dhe botime, shpenzime për energjisë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafonë, shërbimi postar, siguracion automjesh, dieta brenda dhe jashtë vendit, shpenzime pritje-përcjellje të huajve.

Fondi për transfertat korente të huaja (**zëri 605**) për vitin 2017, ishte 1.500.000 lekë, i ndryshuar me shkresë nr. 6579/1 Prot., datë 12.05.2017, “Transferim fonde për vitin 2017” në 1.700.000 lekë ndërsa realizimi është 1.673.605 lekë ose 98% i buxhetit të ndryshuar.

Fondi për transfertat buxhetore familjare dhe individë (**zëri 606**) për periudhën Janar - Gusht 2017, është 723.600 lekë, ndërsa realizimi është 723.600 lekë ose 100% i buxhetit.

3. Shpenzime në investime

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit është 4,000 mijë lekë, ndërsa realizimi 0.

në mijë/lekë

Projekti	Kodi i Projektit	Plan	Fakt	%
Blerje Pajisje	M660001	500	0	0
Pajisje - Kompjuterike	M660009	500	0	0
Blerje automjeti	M660003	3.000	0	0

“Blerje Pajisje”

Për këtë zë të investimeve kanë nisur procedurat e prokurimit në muajin Korrik 2017 dhe likuidimi i kësaj procedure është realizuar në muajin Shtator 2017 me vlerë 404.760 lekë.

"Pajisje kompjuterike"

Për këtë zë të investimeve jemi në procedura prokurimi.

"Blerje automjeti"

Për këtë zë investimi i kemi kërkuar Ministrisë së Financave, me shkresën nr. 260 Prot., datë 23.06.2017, zhblokim të këtij fondi, në përgjigje të cilës Ministria e Financave ka konfirmuar me shkresë nr. 9232/1, datë 03.07.2017, ç'ngurtësimin e këtij fondi. Procedurat për fillimin e realizimit të këtij investimi, nuk janë kryer akoma, për shkak të miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 05.07.2017, "Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit, për vitin 2017".

Bashkëlidhur këtij materiali janë evidencat e raportimit për monitorimin sipas Aneksit 1, 2 të shpenzimeve që ka kryer institucioni i Avokatit të Popullit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,